

## Akti Themelimit

“Premium Investments Group” Shoqëri me Përgjegjësi i c'Kufizuar

Në këtë Statut/Akt Themelimi

- “Liqji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

### Kreu I Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 07/01/2021 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Premium Investments Group SH.P.K.**

(2) Themeluesi i shoqërisë është (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- **Gjergj Poçi**, i biri i Spartak, lindur më 14.04.1984, lindur dhc banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. I40414222R.
- **Dorian Poci**, i biri i Spartak, lindur më 05.07.1977, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. H70705140C.
- **Kristi Naumi**, i biri i Gjergj, lindur më 08.02.1992, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. J20208068C.

#### Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin në:

- ❖ Marrja përsipër e hartimit të projekteve të ndryshme ndërtimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të ndërtimit në përgjithësi;
- ❖ Ndërtim në fushën e turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit dhe ambjenteve të banimit.
- ❖ Administrim dhe mirëmbajtje të të gjithë elementeve për godinat e ndërtuara, të rikonstruktua, sipërfaqeve urbane, rrugëve e shesheve brenda dhe jashtë kompleksve të ndryshëm ndërtimorë, administrim dhe mirëmbajtje e të gjithë elementeve përfshirat turistikë, magazinave të ndryshme, depozitave dhe hangarëve, pistave dhe rrugëve dytësore; eksportimi, importimi, tregtimi i artikujve të ndryshëm;
- ❖ Shfaqja dhe nxitja, promovimi i strukturave ekonomike, investuese dhe sipërmarrëse në fushën e ndërtimit të objekteve urbane e industriale;
- ❖ Pjesëmarrja në prokurime dhe procedura me qëllim marrjen e veprave apo objekteve publike dhe private për projektimin, konstrukcionin, rikonstrukcionin, dekoracion ndërtimor civil dhe ndërtimin në të gjithë ciklin e tij;
- ❖ Aktivitet në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme;
- ❖ Përfaqësimin e subjekteve juridike vendase apo të huaja me objekt të ngjashëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.



**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4:  
Selia**

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën "Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Ali Begeja", Pallati Nr. 108, Hyrja Nr. 1, Apartamenti Nr. 1, Tiranë, Shqipëri".

**Kreu II  
Kapitali**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100,000 (Njëqind mijë) Lekë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Kristi Naumi**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Gjergj Poçi**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 27,500 (Njëzetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë që përben 27.5% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Dorian Poçi**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 22,500 (Njëzetë e dy mijë e pesëqind) Lekë që përben 22.5% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

(2) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të jetë në vlerë monetare dhc/ose në natyrë.

**Neni 6:  
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**


Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përlaqësojnë.

**Neni 7**



## **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit tē një shoqërie me përgjegjësi tē kufizuar e tē drejtat që rrjedhin prej tyre mund tē fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shithblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër tē parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshje në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim tē statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse përmarrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtarë tē shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe tē ekspertëve kontabël tē autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" tē kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit tē politikave tregtarë nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale tē mbledhjeve tē asamblesë;
- i) çështje tē tjera tē parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund tē përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë tē një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund tē vaprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund tē jepet vetëm për një mbledhje tē asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me tē njëtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet tē përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet tē gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

3

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë votë, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me dy të tretën e votave të zotéruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Administratorit nuk i lejohet që të shesë sipërfaqe ndërtimi, nën çmimin e references ligjore, përvèç rasteve kur Asambleja e Përgjithshme e miraton atë shitje me 75%

(4) Personi i mëposhtëm caktohet si Administratorë i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

- **Gjergj Poçi**, i biri i Spartak, lindur më 14.04.1984, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. I40414222R.

Specimenti i nënshkrimit:



**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përsaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therasin Asamblene e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 15**  
**Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatçsc.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëjdis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi çshë kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblyejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblyejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti finanziar-ekspertet**

Neni 16

## **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17**

#### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzoje në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu V**

### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

### **Neni 18**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja osc prishja e shoqërisë mund të bhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e afësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për t'ë caktuar një likuidues.

### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhc shoqëritë tregtare."

### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindë midis Shoqërise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

\* Premium Investments Group \*

Emr mbiemr  
(nënshtatimi)

Emr mbiemr  
(nënshtatimi)

Emr mbiemr  
(nënshtatimi)